

Vlerësimi i nevojave të mekanizmave lokal për mbrojtjen nga diskriminimi dhe qasja deri te drejtësia në komunat:

Manastir, Kumanovë, Strumicë, Tetovë dhe Shtip

Botues:

HERA Asociacioni për edukim shëndetësor dhe hulumtim

Vit:

2016

Autorë:

Sllavčo Dimitrov

Natasha Boshkova

Redaktorë:

Dragana Dërndarevska

Drashko Kostovski

Lektura:

Boban Karapejovski

Përkthimi në gjuhën shqipe:

Gramoz Shabani

Përkthimi në gjuhën angleze:

Igor Raiden

Dizajni grafik:

Monika Mladenovska - Delova

Igor Delov

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

316.647.82:34.037]:352(497.7)

DIMITROV, Slavčo

Vlerësimi i nevojave të mekanizmave lokal për mbrojtjen nga diskriminimi dhe qasja deri te drejtësia në komunat: Manastir, Kumanovë, Strumicë, Tetovë dhe Shtip [Електронски извор] / [autorë Slavčo Dimitrov, Natasha Boshkova ; redaktorë Dragana Dërndarevska, Drashko Kostovski ; përkthimi në gjuhën shqipe Gramoz Shabani]. - Skopje : Health education and research association HERA, 2016

Начин на пристап (URL): <http://hera@hera.org.mk>. - Текст во PDF формат, содржи 36 стр

Наслов преземен од екранот

Опис на изворот на ден 29.07.2016

ISBN 978-608-4598-60-2

а) 1. Гл. ств. насл. 2. Boshkova, Natasha [автор]

а) Дискриминација - Заштита - Правни механизми - Локална самоуправа - Македонија

COBISS.MK-ID 101505546

**Vlerësimi i nevojave
të mekanizmave lokal
për mbrojtjen nga
diskriminimi dhe qasja
deri te drejtësia
në komunat:**

**Manastir, Kumanovë, Strumicë,
Tetovë dhe Shtip**

Përmbajtja:

| | |
|--|----|
| Rezyme | 5 |
| Përfundime | 11 |
| Rekomandime për ndërtimin e kapaciteteve të mekanizmave për mbrojtje nga diskriminimi dhe qasja deri te drejtësia në nivel lokal | 23 |



Rezyme

Qëllimi i këtij vlerësimi është të sigurojë të dhëna për njohuritë, qëndrimet, kapacitetet, praktikat dhe nevojat e përfaqësuesve të mekanizmave lokal për barazi gjinore dhe jo diskriminim në pesë qytete. Fokus i veçantë në suaza të vlerësimit vendoset mbi qëndrimet dhe njohuritë e tyre për barazi gjinore, për gjendjen e njerëzve LGBT. Po ashtu, vlerësimi duhet të japë pasqyrë për mënyrën e sigurimit të ndihmës juridike pa pagesë në rastet e diskriminimit në pesë qytete që është lëndë e kësaj analize. Kriteret për zgjedhjen e qyteteve të cilat janë lëndë e këtij vlerësimi ishin ekzistimi i zyrave rajonale në komunën e analizuar, përfshirja e ndryshme gjeografike si dhe përbërja etnike e popullatës, që jeton në këto komuna, gjegjësisht përfshirja e komunave ku jetojnë pjesëtarët e bashkësive të ndryshme etnike.

Për realizimin e qëllimit të vlerësimit, hulumtuesit zhvilluan listë të indikatorëve de jure dhe de fakto (në mënyrë të plotësuar të ndara në input, output dhe indikatorë për procesin), në bazë të cilave është bërë mbikëqyrje të situatës për barazinë gjinore dhe jo diskriminim, veçanërisht me fokus mbi orientimin seksual dhe identitetin gjinor. Veglat metodologjike të hulumtimit përfshinë: a) desktop hulumtim – grumbullimi i burimeve sekondare të informatave, b) intervistë – hulumtim në terren për grumbullimin e të dhënave primare dhe c) analizë sistemore dhe interpretuese dhe përgatitja e raportit përfundimtar me përfundime dhe rekomandime për hapat e ardhshëm, të cilët do të sjellin deri te plotësimi i gjendjes së dëshiruar në funksionimin dhe efikasitetin e mekanizmave lokal për mbrojtjen nga diskriminimi. Në kuadër të hulumtimit u realizuan intervista të strukturuar dhe thelbësore me Koordinatorin për mundësi të barabarta në njësitë e pushtetit lokal, përfaqësues i zyrës rajonale të Ministrisë së Drejtësisë dhe zëvendësit e Avokatit të Popullit, në secilin prej këtyre qyteteve në kuadër të hulumtimit (Shtip, Manastir, Strumicë, Tetovë dhe Kumanovë). Gjithsej 14 intervista u realizuan: 3 intervista me KMB në Komunën e Shtipit, Kumanovës dhe Strumicës, 5 intervista me zëvendësit e AP në të gjitha komunat që ishin fokus të hulumtimit, dhe 5 intervista me përfaqësuesit e zyrave rajonale të MD në të gjitha 5 komunat. Koordinatori në Komunën e Manastirit iu përgjigj një pjese të pyetjeve në formë të shkruar si përgjigje ndaj kërkesës për qasje deri te informatat me karakter publik. Në Komunën e Tetovës nuk u realizua intervistë me KMB, por me person tjetër të emëruar nga komuna.

Gjetjet kryesore të hulumtimit tregojnë për **nevojën nga ndryshime dhe plotësime të ligjeve dhe politikave për mundësi të barabarta dhe mbrojtjen nga diskriminimi në nivel nacional**. Në të vërtetë, përcaktimi i përfshirjes së mbrojtjes dhe barazisë në Ligjin për mundësi të barabarta mes grave dhe meshkujve është rregulluar në mënyrë të rreptë dhe e definuar vetëm në bazë të kategorisë së gjinisë, derisa rendësit e shumanshme dhe përfshirja e kategorisë së gjinisë janë tërësisht të përjashtuara, duke përfshirë edhe ndër seksionet strukturore dhe politike të gjinisë me boshtet tjera të kënaqësisë shoqërore dhe pabarazisë. Ligji tërësisht i përjashton nga mbrojtja gratë me orientim homoseksual dhe biseksual, si dhe gratë transgjimore, gjegjësisht njerëzit. Të kuptuarit e këtillë të ngushtë të gjinisë dhe barazisë gjinore reflektohet edhe mbi politikat konkrete, aktivitetet, masat dhe mekanizmat për mbrojtje nga diskriminimi dhe promovimi i barazisë gjinore.

Më tutje, Ligji për ndihmë juridike pa pagesë ngushtë i përcakton kriteret për atë se kush mund të fitojë të drejtë për ndihmë juridike pa pagesë, dhe definojnë listë të mbyllur të çështjeve juridike për të cilat mund të sigurohet ndihmë juridike pa pagesë, ku diskriminimi, gjuha e urrejtjes dhe veprat nga urrejtja nuk janë përfshirë në mënyrë eksplicite në listën e çështjeve juridike për të cilat mund të sigurohet ndihmë juridike pa pagesë. Zbrazëtira e këtillë krijon huti edhe mes vetë përfaqësuesve të zyrave rajonale të MD, të cilët sipas deklaratave në intervista nuk dinin të përgjigjen nëse në listën e çështjeve juridike për të cilat mund të aprovohet ndihmë juridike hynë diskriminimi ose gjuha e urrejtjes.

Pjesë e rëndësishme e **strategjive nacionale dhe planeve të verimit** në fushën e barazisë gjinore dhe jo diskriminimit nuk parashohin aktivitete specifike për forcimin e mekanizmave lokal për mundësi të barabarta dhe mbrojtjen nga diskriminimi, e as nuk i përjashtojnë NJVL si institucione përgjegjëse në zbatimin e aktiviteteve të planifikuara. Strategjia nacionale për barazi dhe jo diskriminim në bazë të përkatësisë etike, mosha, pengesa mentale dhe gjinia për periudhën 2012-2015 është përpiluar në bazë të dispozitave kufizuese dhe përjashtuese për bazat e diskriminimit.

Vlerësimi i **situatës në nivel lokal** flet për mungesën e transparencës në shpalljen publike të Statuteve, Rregulloreve për punë të Këshillit të komunës, dhe aktet tjera nënligjore, si dhe politikat për mundësi të barabarta dhe jo diskriminimi në internet faqet e komunave.

Vetëm dy prek komunave të përfshira në vlerësim e kanë rregulluar në mënyrë të veçantë dhe e kanë specifikuar vendin e punës me kompetencat dhe rregulloren për punë për pozitën KMB, derisa te komunat tjera kompetencat e KMB janë rregulluar si obligime plotësuese të cilat janë pjesë përbërëse e vendeve tjera të caktuara të punës. Vendosja e këtillë strukturore e NJVL nuk lejon që nëpunësit shtetëror të emëruar për KMB tërësisht t'i përkushtohen obligimeve të tyre të punës dhe t'i realizojnë aktivitetet për avancimin e mundësive të barabarta dhe mbrojtjen nga diskriminimi.

Edhe krahas asaj që pjesa më e madhe e komunave kanë zhvilluar plane të veprimit, programe vjetore se strategji për barazi gjinore dhe jo diskriminim, asnjë komunë që ishin në fokus të hulumtimit nuk e përfshinë diskriminimin në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor si fushë prioritare, e as nuk janë paraparë aktivitete në drejtim të pengimit dhe mbrojtjes nga diskriminimi në bazë të orientimit seksuale dhe identitetit gjinor.

Të gjithë përfaqësuesit e mekanizmave lokal për mbrojtje nga diskriminimi disponojnë **njohuri adekuate** për konceptet e barazisë gjinore dhe përfshirjen e perspektivës gjinore në rrjedhat kryesore. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se vërehet të kuptuarit e ngushtë të barazisë gjinore. Me përjashtim të KMB, përfaqësuesit tjerë të mekanizmave lokal për mbrojtje nga diskriminimi tregojnë se të kuptuarit e kufizuar të koncepteve të gjinisë dhe seksit. Nevojë më të madhe për avancimin e njohurive për faktet dhe të dhënat të cilat kanë të bëjnë me njerëzit LGBTI dhe përvojat e tyre, kanë përfaqësuesit e zyrave rajonale të MD të autorizuar të japin ndihmë juridike pa pagesë, derisa shumica e përfaqësuesve të mekanizmave lokal nuk dinë aspak se me çfarë sfidash ballafaqohen njerëzit transgjinor në realizimin e të drejtave të tyre dhe jetën e përditshme. Me përjashtim të një pjese të vogël të KMB dhe zëvendësit e AP, përfaqësuesit e mekanizmave lokal kanë nevojë nga avancimi i njohurive lidhur me Ligjin për pengimin dhe mbrojtje nga diskriminimi, si dhe legjislacioni nacional deh ndërkombëtar, që ka të bëjë me mbrojtjen e të drejtave de jo diskriminimin e LGBT njerëzve.

KMB dhe zëvendësit e AP tregojnë nivel të mesëm deri të lartë të **ndjeshmërisë dhe tolerancës** ndaj homoseksualëve, derisa përfaqësuesit e zyrave lokale të MD tregojnë nivel të ulët deri të mesëm të tolerancës. Te të gjithë përfaqësuesit e mekanizmave lokal vërehet tolerancë dhe ndjeshmëri e ulët kur bëhet fjalë për njerëzit transgjinor.

Në raport me **vendosen faktike dhe funksionimin e mekanizmave për mbrojtje nga diskriminimi në nivel lokal** janë identifikuar disa probleme. Komunat shprehin interesim të vogël për caktimin e qartë të kompetencave, detyrave dhe obligimeve të anëtarëve të KMBGM dhe KMB. Më tutje, bashkëpunimi ose ngritja e iniciativave të barabarta mes KMB dhe KMBGM në disa komuna mungon tërësisht, derisa në komuna tjera është vërejtur përputhje, gjegjësisht mos ndarja e kompetencave dhe aktiviteteve mes KMBGM dhe KMB.


Iniciativat për promovimin e parimeve të jo diskriminimit, si dhe për mbrojtje nga diskriminimi që KMB i kanë si kompetenca t'i nisin janë pothuaj të pavërejtura, në numër të vogël, në disa komuna mungojnë tërësisht, ndërsa në ato komuna ku janë ngritur, shpesh përfshijë aktivitete të njehershme. Asnjë prej KMB në të gjitha komunat e përfshira në këtë vlerësim nuk kanë pasur iniciativë lidhur me të drejtat e LGBT njerëzve.

Po ashtu, asnjëri nga zëvendësit e intervistuar të AP nuk ka ngritur procedurë me iniciativën e tij për diskriminim në bazë të seksit/gjinisë, orientimit seksual ose identitetit gjinor. Është vërtetuar mungesa e plotë e kërkesave ose ndihmës të miratuar juridike pa pagesë në rastet e diskriminimit, duke përfshirë edhe diskriminimin në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.

KMB kanë praktikën më të mirë të **bashkëpunimit me shoqatat e qytetarëve** të cilët punojnë në fushën e barazisë gjinore dhe të drejtave të njeriut, ndërsa praktikë relativisht të mirë të bashkëpunimit me SHQ kanë edhe zëvendësit e AP. Bashkëpunimi i zyrave lokale të MD me SHQ është në nivel të bashkëpunimit me shoqatat, të cilat janë të autorizuara të ofrojnë ndihmë juridike pa pagesë, në pajtim me LNJP. Me përjashtim të dy zëvendësve të AP, asnjë nga mekanizmat tjerë në nivel lokal nuk ka pasur bashkëpunim me SHQ të cilët punojnë në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të LGBT njerëzve.

Brengos edhe **koordinimi joadekuat mes mekanizmave të ndryshëm lokal** për mbrojtje nga diskriminimi, që paraqet edhe burim të mungesës së përgjigjes ndaj gjendjeve, e me këtë thellohet edhe diskriminimi.

Mekanizmat lokal, si dhe përfaqësuesit joadekuat në nivel nacional nuk kanë mekanizma dhe metodologji të zhvilluar për përcjelljen e gjendjes me mundësitë e barabarta dhe jo diskriminimin në nivel lokal.



KMB dhe zëvendësit e AP tregojnë nivel të mesëm deri të lartë të ndjeshmërisë dhe tolerancës ndaj homoseksualëve, derisa përfaqësuesit e zyrave lokale të MD tregojnë nivel të ulët deri të mesëm të tolerancës. Te të gjithë përfaqësuesit e mekanizmave lokal vërehet tolerancë dhe ndjeshmëri e ulët kur bëhet fjalë për njerëzit transgjjinor.

2.

Përfundime

Nevojat dhe sfidat kyçe të identifikuar në punën e mekanizmave lokal për mbrojtje nga diskriminimi në zbatimin e aktiviteteve në nivel lokal, të cilat kanë të bëjnë me promovimin e barazisë, jo diskriminimit në përgjithësi. Si dhe në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor i përfshijnë: resurset e kufizuara dhe të pamjaftueshme financiare, resurset e pamjaftueshme teknike, përgatitjen e dobët kadrovike për veprim në raste të diskriminimit, si dhe atmosferën e përgjithshme të homofobisë në opinionin e gjerë dhe informimin e pamjaftueshëm të qytetarëve për mekanizmat për mbrojtje nga diskriminimi.

Në bazë të gjetjeve kryesore dhe problemeve të identifikuar, në suaza të vlerësimit ofrohen edhe rekomandime konkrete për përmirësimin e gjendjes dhe tejkalimin e pengesave themelore dhe mungesave në kapacitete, funksionimin dhe efikasitetin e mekanizmave lokal për mbrojtje nga diskriminimi. Rekomandimet i adreson Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Ministria e Drejtësisë dhe Kuvendi i RM, ndërsa në drejtim të ndryshimeve, plotësimeve dhe miratimeve të ndryshimeve në LMBGM dhe LMJP. Fokus i veçantë në rekomandime vihet edhe mbi nevojat për përmirësimin e politikave nacionale dhe strategjive për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi dhe barazi gjinore, ndërsa në kompetenca të MPPS. Pjesa më e madhe prej rekomandimeve kanë të bëjnë me Njësinë e pushtetit lokal, duke cekur hapa konkret për përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies, rregullimin dhe vërtetimin e kompetencave të KMB dhe KMBGM, planifikimin dhe buxhetimin e iniciativave dhe aktiviteteve më fushën e diskriminimit (dhe konkretisht diskriminimi në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor) dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kapaciteteve të KMB, zëvendësit e AP dhe përfaqësuesit e MD. Në këto rekomandime veçanërisht theksohet nevoja për mekanizmat lokal për mbrojtje nga diskriminimi (KMBGM, KMB de MD) dhe qasja deri te drejtësia e qytetarëve në nivel lokal (përfaqësuesit e zyrave rajonale të MD) të vendosin dhe të zhvillojnë bashkëpunim për shkak të përcjelljes gjithëpërfshirëse të gjendjes me mundësitë e barabarta dhe jo diskriminimit, duke e përfshirë dhe duke e mbështetur në mënyrë aktive punën e shoqatave të qytetarëve të cilët punojnë në këtë fushë, duke përfshirë edhe LGBT organizatat. Në përputhje me gjetjet kryesore, rekomandohet që AP dhe MD të zhvillojnë metodologji bashkëkohore për evidentimin, përpunimin dhe prezantimin e rezultateve nga puna në fushën e diskriminimit dhe lidhur me ndihmën juridike të kërkuar/siguruar. Më në fund, me rekomandimet adresohen edhe shoqatat e qytetarëve për mbrojtjen e të drejtave të LGBT njerëzve, gjegjësisht nevoja që ta rritin

komunikimin me mekanizmat lokal për mbrojtje nga diskriminimi për shkak të inicimit dhe përmirësimit të bashkëpunimit.

Liget dhe politikat për mundësi të barabarta dhe mbrojtja nga diskriminimi në nivel nacional

Edhe krahas asaj se qëllimi kryesor i LMBGM është arritja e barazisë gjinore dhe përfshirjes së perspektivës gjinore në rrjedhat dhe politikat kryesore, definimi i përfshirjes së mbrojtjes dhe barazisë në Ligj janë rregulluar dhe definuar rreptësisht në bazë të kategorisë së gjinisë. Njohuritë e shumanshme dhe përfshirja e kategorisë gjini, duke përfshirë edhe ndër seksionet strukturore dhe politike e gjinisë me boshtet tjera të kënaqësisë dhe pabarazisë shoqërore dhe të kuptuarit konsekuent të konceptit për barazi gjinore që del nga korniza e këtyllë e gjinisë, reduktohen në kategorinë biologjike për gjininë. Lidhur me të kuptuarit e këtyllë reflektohet edhe mbi politikat konkrete, aktivitetet dhe masat dhe mekanizmat për mbrojtje nga diskriminimi dhe promovimi i barazisë gjinore, e dukshme edhe në atë se Ligji në tërësi i përjashton nga mbrojtja gratë me orientim homoseksual dhe biseksual, si dhe gratë transgjinore, gjegjësisht njerëzit.

LNJP i përcakton ngushtë kriteret rreth asaj se kush mund të fitojë të drejtën e ndihmës juridike pa pagesë, e në praktikë një numër i vogël i qytetarëve e realizojnë të drejtën e ndihmës juridike pa pagesë. Më tutje, lista e mbyllur e çështjeve juridike për të cilat mund të sigurohet ndihmë juridike pa pagesë nuk e mundëson qasjen pa pengesë deri te drejtësia. Mbrojtja nga diskriminimi nuk është çështje juridike e cekur në mënyrë eksplicite për të cilën qytetarët do të mund të fitojnë ndihmë juridike pa pagesë. Një pjesë e çështjeve juridike për të cilat Ligji ofron ndihmë juridike, si dhuna në familje, marrëdhëniet në punë ose viktimat e veprave penale e hapin mundësinë për interpretim më të gjerë përmes së cilës do të inkuadrohej edhe diskriminimi si çështje juridike, për të cilën do të ofrohej ndihmë juridike, por përfshirja e këtyllë eksplicite e diskriminimit e hap mundësinë për vendimmarrje arbitrore dhe të paligjshme në

praktikë. Po ashtu, zbrazëtira e këtillë krijon huti edhe mes vetë përfaqësuesve të zyrave rajonale të MD, të cilat sipas deklaratave në intervista nuk dinin të përgjigjen nëse në listën e çështjeve juridike, për të cilat mund të miratohet ndihmë juridike hyn edhe diskriminimi ose gjuha e urrejtjes.

Pjesë e rëndësishme e strategjive nacionale dhe planeve aksionare në fushën e barazisë gjinore dhe jo diskriminimit, përveç pikave të përgjithshme ku flet për nevojën e përfshirjes së perspektivës gjinore në nivel nacional dhe lokal, nuk parashohin aktivitete specifike për forcimin e mekanizmave lokal për mundësi të barabarta dhe mbrojtjen nga diskriminimi. Po ashtu, njësitë e vetëqeverisjes lokale nuk janë identifikuar si institucione përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara.

Vërehen edhe dispozitat kufizuese dhe përjashtuese për bazat e diskriminimit në bazë të cilave është përpiluar edhe Strategjia nacionale për barazi dhe jo diskriminim në bazë të përkatësisë etnike, moshës, pengesës mentale dhe gjinisë për periudhën 2012-2015. Nuk është e qartë sipas cilave kriteret propozuesi e ka vendosur fokusin mbi disa baza për mbrojtje nga diskriminimi, kur Raporti i KMD për vitin 2001 tregon për problem të përgjithshëm me diskriminimin. KMD vepron sipas parashtesa të cilat krahas përkatësisë etnike kanë të bëjnë me mbrojtjen nga diskriminimi në bazë të statusit shëndetësor, përkatësisë së grupit të marginalizuar dhe statusit personal ose shoqëror në vitin 2002, derisa në vitin 2013 është rritur numri edhe për mbrojtje nga diskriminimi në bazë të përkatësisë politike dhe mbi baza tjera nga LPMD.

Politikat për mundësi të barabarta dhe mbrojtja nga diskriminimi në nivel lokal

Sfidë kryesore në analizën e dokumenteve dhe politikave lokale të komunave të zgjedhura është mungesa e transparencës në shpalljen publike të Statuteve, Rregulloreve për punë të Këshillit të komunave, dhe akteve tjera nënligjore, si

dhe politikat për mundësi të barabarta dhe jo diskriminimi në internet faqet e komunave.

Vetëm dy prej komunave të përfshira në këtë vlerësim kanë vend pune të vendosur në veçanti dhe me specifika me kompetenca dhe rregullore për punë të punës për pozitën e KMB. Te komunat tjera kompetencat e KMB janë rregulluar si obligime plotësuese, të cilat janë pjesë përbërëse e vendeve tjera të caktuara të punës. Bile edhe ato KMB pozita e të cilëve është e rregulluar veçmas me sistematizimin në NJVL, krahas rregullores për punë se si KMB veprojnë dhe një sërë obligimesh tjera pune në suaza të komunës. Vendosja e këtillë në strukturën e komunave, nuk lejon që nëpunësit shtetëror të emëruar për KMB tërësisht t'i përkushtohen detyrave të tyre të punës dhe të realizojnë aktivitete për avancimin e mundësive të barabarta dhe mbrojtjen nga diskriminimi në nivel lokal, problem që u theksua e Koordinatorëve të intervistuar për qëllimet e këtij vlerësimi.

Asnjë nga planet e veprimit, strategjitë dhe programet vjetore të analizuarat të komunave, në fokus nuk e përfshijnë diskriminimin në bazë të orientimit seksual dhe identitetin gjinor si fushë prioritare, e as nuk janë paraparë aktivitete në drejtim të pengimit dhe mbrojtjes nga diskriminimi në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.

Edhe krahas asaj se planet e veprimit dhe strategjitë në mënyrë deklarative përfshijnë plan për vlerësim dhe monitorim, mungon llogaridhënia, qasja publike dhe vlerësimi i atyre të realizuara, gjegjësisht planet të veprimit, strategjitë dhe programet e përfunduara. Krahas raporteve që KMB i dorëzon deri te MPPS, nuk ekzistojnë analiza dhe vlerësime tjera të kryera mbi bazë të indikatorëve matës de të caktuar, të cilët do të ishin të kapshëm për qasje për opinionin e interesuar.

Të kuptuarit gjithëpërfshirës i konceptit të barazisë gjinore dhe praktikave për perspektivën gjinore në rrjedhat kryesore të personat përgjegjës (për barazi gjinore dhe mbrojtjen nga diskriminimi)

Të gjithë përfaqësuesit e mekanizmave lokal për mbrojtje nga diskriminimi disponojnë njohuri adekuate për konceptet e barazisë gjinore dhe përfshirjen e perspektivës gjinore në rrjedhat kryesore. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se vërehet të kuptuarit e ngushtë të barazisë gjinore, e dukshme në fushat ku identifikohet pabarazia gjinore. Me përjashtim të stereotipave gjinor të cilët kanë të bëjnë me rolin shoqëror të gruas si amvise, vërehet fiksimi dhe reduktimi i transformimit gjinor vetëm në institucionin familje, dhe pjesërisht në tregun e punës, gjegjësisht në zgjedhjen dhe distribuimin gjinor të profesioneve (femërore dhe mashkullore). Fushat e seksualitetit, jetës afektive, role të shumta shoqërore dhe prerogative gjinore si konsistuentë për kuptimin e gjinisë dhe barazisë gjinore mungojnë në kuptimin e barazisë gjinore dhe transformimin si kusht për arritjen e të njëjtit. Mungon edhe të kuptuarit për ndër seksion të strukturuar dhe politikë në të kuptuarit e barazisë gjinore, ndërsa zbrazëtira e këtillë në strukturat e njohurisë është evidente edhe në politikat që aktorët në nivel lokal i krijojnë, gjegjësisht mungesa e grave të cilat janë të marginalizuara si rezultat i parametrave tjerë dhe statuseve shoqërore.

KMB tregojnë për shkallë më të lartë të njohjes së dallimeve mes kategorive gjini dhe seks, derisa zëvendësit e AP dhe përfaqësuesit e zyrave rajonale të MD tregojnë mos njohuri ose të kuptuarit e kufizuar për dallimet mes kategorive gjini dhe seks.

Të gjithë përfaqësuesit e intervistuar të mekanizmave lokal për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi të kuptuarit e barazisë gjinore, gjininë dhe seksin e fusin në korniza binare të dy gjinive dhe të dy sekseve, në përgjithësi duke mos ditur ose duke mos i përfshirë në konceptet për barazi gjinore njerëzit ndërseksual dhe transgjinor.

Njohja e fakteve bashkëkohore dhe të pranuarra nga shkenca për homoseksualitetin dhe transgjinoren dhe informimi për gjendjen me të drejtat e njeriut të LGBT njerëzve

KMB dhe zëvendësit e AP disponojnë me njohuri adekuate për faktet dhe të dhënat të cilat kanë të bëjnë me LGBT njerëzit. Nevoja më e madhe për avancimin e njohurive për faktet dhe të dhënat që kanë të bëjnë me LGBT njerëzit dhe përvojat e tyre kanë përfaqësues në zyrat rajonale të MD të autorizuar të ofrojnë ndihmë juridike pa pagesë.

Më shumë se gjysma e të gjithë përfaqësuesve të intervistuar të mekanizmave lokal për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi nuk dinë aspak se me çfarë sfidash ballafaqohen njerëzit transgjinor në realizimin e të drejtave të tyre dhe jetën e përditshme.

Njohja e rregullores ligjore relevante dhe mekanizmat ekzistues për mbrojtje nga diskriminimi në Maqedoni

KMB disponon me njohuri adekuate të LPMD, gjatë së cilës gjysma e të anketuarve tregojnë njohuri të hollësishme, derisa të tjerët njohuri të pjesshme ose të dobëta për LPMD. Shumica e KMB të intervistuarra kanë njohuri të kufizuara edhe rreth kompetencave të tyre dhe kompetencave të KMBGM për veprim në fushat e jo diskriminimit.

Zëvendësit e AP tregojnë njohuri adekuate me LPMD dhe organet të cilat kanë kompetenca për mbrojtje nga diskriminimi, ndërsa të njëjtët edhe janë tërësisht

të njoftuar me kompetencat e tyre për veprim lidhur me diskriminimin në pajtim me Ligjin.

Nevoja më e madhe nga avancimi i njohurive për LPMD dhe organet kompetente për mbrojtje dhe veprim kanë përfaqësuesit në zyrat rajonale të MD të autorizuar të japin ndihmë juridike pa pagesë.

Nga të gjithë përfaqësuesit e intervistuar të mekanizmave lokal për pengim dhe mbrojtje nga diskriminimi, vetëm katër prej tyre janë të njoftuar me ligjin, që e rregullon diskriminimin në bazë të orientimit seksual, duke e cekur Ligjin për pengim dhe mbrojtje nga diskriminimi.

Shkalla e sensibilizimit dhe tolerancës ndaj pakicave seksuale dhe gjinore

KMB tregojnë nivel të ulët të distancës sociale lidhur me homoseksualët, gjegjësisht shkallë të mesme deri të lartë të tolerancës. Përjashtime nga niveli i ulët të distancës sociale shprehin një pjesë të KMB në rastet kur personi me orientim homoseksual do të ishte kryes i funksionit politik ose kryetar i shtetit.

Zëvendësit e Avokatit të popullit pa përjashtim tregojnë distancë të ulët sociale, derisa përfaqësuesit e zyrave rajonale të MD tregojnë distancë më të lartë sociale ndaj homoseksualëve në situata të ndryshme të supozuara, gjegjësisht distancë të mesme deri të lartë sociale.

Rezultatet e shkallës së distancës sociale është mjaft e ndryshme mes të gjithë përfaqësuesve të mekanizmave lokal për mbrojtje nga diskriminimi kur bëhet fjalë për situata të supozuara dhe role në të cilat do të gjendej personi transgjinor, gjegjësisht mesatarisht prej të gjithë përfaqësuesve të mekanizmave lokal për mbrojtje nga diskriminimi, niveli i distancës sociale është prej të mesmes drejt të lartës.

Për pjesën më të madhe të anketuarve, ndikim pozitiv për ndryshimin e qëndrimeve të tyre ndaj LGBT popullatës, gjegjësisht për shkallën e rritur të tolerancës, kanë pasur ndryshimi i përgjithshëm në shoqëri, përfaqësimi i rritur medial dhe përfaqësimi i homoseksualëve dhe qasja më e madhe e informatave të cilat i shembin stereotipat dhe definicionet e stigmatizuara.

Vendosja faktike dhe funksionimi i mekanizmave për mbrojtje nga diskriminimi në nivel lokal

Statutet e NJVL të anketuara përmbajnë më pak informata për kompetencat e KMBGM rreth përshkrimit që e jep LMBGM. E ngjashme është edhe përgjigja e komunave kur është fjala për rregullimin e punës së KMB. Kjo tregon se komunat nuk kanë interesim të madh që në mënyrë të qartë t'i vërtetojnë kompetencat, detyrat dhe obligimet e anëtarëve të KMBGM.

Në një pjesë të komunave mungon pothuaj çfarëdo bashkëpunimi ose ngritja e iniciativave të përbashkëta mes KMB dhe KMBGM. U përmend edhe ajo se disa KMBGM pothuaj janë tërësisht pasive, me çka pesha më e madhe dhe përgjegjësia për planifikim, ngritjen dhe zbatimin e iniciativave dhe aktiviteteve në fushën e mundësive të barabarta dhe jo diskriminimit është hedhur mbi KMB.

Iniciativat për promovimin e parimeve të jo diskriminimit, si dhe për mbrojtje nga diskriminimi që KMB kanë kompetenca t'i ngrenë pothuaj nuk vërehen, në numër të vogël, në disa prej komunave mungojnë tërësisht, ndërsa në ato komuna ku janë ngritur, shpesh organizohen trajnime të njehershme.

Asnjë nga KMB prej të gjitha komunat e përfshira në vlerësim nuk ka pasur iniciativë lidhur me të drejtat e LGBT njerëzve. Deri më tani asnjë komunë nuk ka realizuar aktivitet të orientuar drejt mundësive të barabarta dhe mbrojtjes nga diskriminimi mbi baza të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, edhe

krahas asaj që KMB të intervistuar tregojnë vetëdije për problemet dhe diskriminimin e LGBT njerëzve.

Po ashtu, asnjë prej zëvendësve të AP të intervistuar nuk ka ngritur procedurë me iniciativën e tij për diskriminim në bazë të gjinisë/seksit, orientimit seksual ose identitetit gjinor.

Të dhënat e disponueshme nga analizat e mëparshme të zbatimit të LNJP dhe informatat e grumbulluara përmes intervistave tregojnë për mungesën e plotë të kërkesave ose ndihmën juridike pa pagesë të miratuar në rastet e diskriminimit, duke përfshirë edhe diskriminimin në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Përjashtim nga praktika e këtillë paraqesin numri i madh i kërkesave në rastet e dhunës familjare. Por edhe krahas asaj që dhuna familjare bazohet mbi diskriminimin në bazë të gjinisë/seksit, këto kërkesa/raste nuk evidentohen në mënyrë eksplicite si raste të diskriminimit.

Praktika e deritanishme tregon bashkëpunim solid me KMB me shoqatat e qytetarëve, veçanërisht me SHQ të cilat punojnë në fushën e barazisë gjinore dhe luftën kundër dhunës familjare. Megjithatë, asnjë prej KMB deri tani nuk ka bashkëpunuar me shoqatat të cilat punojnë në avancimin e të drejtave të LGBT njerëzve, e pak prej tyre janë njoftuar edhe me këto shoqata.

Bashkëpunimi i zëvendësve të AP me shoqatat është në nivel mesatarisht të ulët. Përveç njërit prej zëvendësve të AP, i cili u përgjigj se nuk kanë pasur kurrfarë bashkëpunimi me shoqatat e qytetarëve, zëvendësit tjerë treguan për ekzistencën e bashkëpunimit të dobët, të pa vazhdueshëm ose të njehershëm me shoqatat. Shembull pozitiv të bashkëpunimit me SHQ të cilët punojnë në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të LGBT njerëzve përmendën dy zëvendës të AP, derisa të tjerët nuk kanë vendosur bashkëpunim me këto SHQ.

Bashkëpunimi i zyrave lokale të MD me SHQ është vetëm në nivel të bashkëpunimit me shoqatat, të cilat janë të autorizuara të ofrojnë ndihmë juridike pa pagesë. Praktika e deritanishme tregon edhe mungesë të plotë të bashkëpunimit me SHQ të cilat punojnë në mbrojtjen dhe promovimin e LGBT njerëzve, dhe pothuaj askush prej të anketuarve nuk është i njoftuar me këto shoqata dhe punën dhe problemet e tyre.

Zyrat rajonale të Avokatit të popullit pothuaj janë të përjashtuara nga çfarëdo komunikimi me KMB ose me KMBGM që paraqet pengesë në koordinimin e politikave dhe strategjive në nivel lokal. Po ashtu, asnjë prej zyrave rajonale të MD nuk kanë iniciuar ose të ketë vendosur bashkëpunim me KMB lokale, e as nuk janë njoftuar me kompetencat dhe punën e tyre. Bashkëpunimi me institucionet tjera në nivel lokal është në nivel të komunikimit, i domosdoshëm për grumbullimin e dokumentacionit të nevojshëm për kompletimin e kërkesave të marra për NJP dhe dërgimin e tyre në MD. Hulumtimet në disa komuna, pjesë e këtij vlerësimi, tregojnë për nivelin e lartë të stigmës dhe diskriminimit ndaj LGBT njerëzve, shqetësimi në institucionet arsimore, veprimi diskriminues i institucioneve kompetente në qasjen deri te të mirat dhe shërbimet.¹ Koordinimi jo adekuat mes institucioneve nuk jep përgjigje adekuate për gjendjet, e me këtë thellohet diskriminimi.

Intervistat e realizuara dhe pasqyra e praktikës së deritanishme të AP tregojnë për mosekzistimin e metodologjive të zhvilluara përmes së cilës do të bëhej kontroll dhe grumbullim i të dhënave për numrin e saktë të parashtesave të dorëzuara për diskriminim, parashtesa për diskriminim mbi të cilat është vepruar, dhe ndarja e këtyre të dhënave mbi baza të ndryshme për diskriminim dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale në të cilat parashtesa është dorëzuar.

Mungon metodologjia e zhvilluar dhe sistemi për evidencë edhe në kuadër të MD lidhur me ndihmën juridike të kërkuar/të siguruar. Rezultati përfundimtar i lëshimit të këtillë është mungesa e të dhënave statistikore në Ministrinë e Drejtësisë për njësitë rajonale, dhe rreth asaj se sa dhe cilët qytetarë, dhe për cilat probleme juridike është siguruar ndihmë juridike.

Praktika e deritanishme e zëvendësve të AP tregojnë nivel të rëndësishëm të aktiviteteve të ndërmarra për promovimin e punës dhe kompetencave të zëvendësve të AP në nivel lokal, si dhe prezantimi i tyre në media dhe komunikimi me qytetarët, distribuimi i materialeve informative dhe broshurave, transparenca në prezantimin e raporteve dhe gjendjeve aktuale etj.

¹ Koalicioni të drejtat seksuale dhe shëndetësore të bashkësive të margjinalizuara. Analizë e mekanizmave për mbrojtje nga diskriminimi i bashkësive të margjinalizuara në nivel lokal: Komuna e Manastirit, Komuna e Strumicës dhe Komuna e Qendrës, 2015. Shkarkoni në: http://www.merc.org.mk/Files/Write/Documents/01243/mk/Analiza_Koalicija-za-seks..pdf.

Një prej problemeve kyçe në praktikë të zyrave rajonale të MD është ndalesa e mundësisë për reklamim dhe promovim të shërbimeve dhe kompetencave të zyrave rajonale dhe shoqatave të autorizuara të ofrojnë ndihmë juridike pa pagesë. Kufizimet e këtilla paraqesin pengesë për promovimin e kompetencave dhe qasja e zyrave rajonale të MD.

3.

Rekomandime për ndërtimin e kapaciteteve të mekanizmave për mbrojtje nga diskriminimi dhe qasja deri te drejtësia në nivel lokal

Nevojat dhe sfidat në punën e mekanizmave lokal për mbrojtje nga diskriminimi

- + Problemi kryesor i identifikuar nga KMB gjatë zbatimit të më tepër aktiviteteve në nivel lokal të cilat anë të bëjnë me promovimin e barazisë, jo diskriminimin në përgjithësi, si dhe në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, janë resurset e pakta financiare në NJVL të cilat nuk mund të sigurojnë mjete të mjaftueshme, me të cilat do të sigurohej angazhim i plotë pune dhe përkushtim special i KMB.
- + Vërejtje të ngjashme dhanë edhe zëvendësit e AP, të cilët e theksojnë pavarësinë financiare si të domosdoshme për refuzimin e plotë dhe funksional të punës së zyrës.
- + Probleme tjera që i identifikojnë një pjesë të zëvendësve të AP janë: të qenit të mbyllur të organeve tjera shtetërore në nivel lokal, mosveprimi sipas vendimeve të AP nga ana e institucioneve të cilat i kanë shkëlur të drejtat e qytetarëve dhe informimi i pamjaftueshëm qytetarëve për LPMD dhe mekanizmat të cilat janë në dispozicion për mbrojtje nga diskriminimi.
- + Sfida më e madhe me të cilën ballafaqohen përfaqësuesit e zyrave rajonale të MD, në përgjithësi me kryerjen e punës së tyre, është mungesa e resurseve teknike themelore në kryerjen e përditshme të obligimeve. Përfaqësuesit e zyrave rajonale të MD si sfidë e theksojnë edhe përgatitjen të pamjaftueshme kadrovike për njohjen dhe veprimin në raste të diskriminimit, e veçanërisht në kontekst të diskriminimit mbi baza të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.
- + Ministria e Punës dhe Politikës Sociale të propozojë, ndërsa Kuvendi i Republikës së Maqedonisë ta miratojë tekstin e Ligjit për mundësi të barabarta të grave dhe meshkujve, ku do të harmonizohen qëllimet të cilat duhet të arrihen, gjegjësisht përfshirja e gjinisë, identitetit gjinor, shprehjes gjinore dhe orientimit seksual si baza për eliminimin e diskriminimit dhe vendosjen e mundësive të barabarta mes grave dhe meshkujve;
- + Ministria e Punës dhe Politikës Sociale të propozojë, ndërsa Kuvendi i Republikës së Maqedonisë të miratojë plotësimin e LMBGM në pjesën e kompetencave të

makinerisë lokale për barazi gjinore për mbrojtje nga diskriminimi në pajtim me LPMD;

- + Ministria e Punës dhe Politikës Sociale të propozojë, ndërsa Kuvendi i Republikës së Maqedonisë të miratojë plotësisht të LPBD me përfshirjen e orientimit seksual dhe identitetit gjinor si baza mbi të cilat ndalohet diskriminimi në të gjitha sferat;
- + Ministria e Drejtësisë të propozojë, ndërsa Kuvendi i Republikës së Maqedonisë të miratojë ndryshime të LNJP në drejtim të: 1. Zgjerimit të listës së çështjeve juridike për të cilat mund të sigurohet ndihmë juridike pa pagesë përmes përfshirjes eksplicite të diskriminimit si çështje juridike për të cilën mund të kërkohet/sigurohet NJP; 2. Heqja e ndalesës për reklamim dhe promovim të shërbimeve dhe kompetencave të zyrave rajonale dhe shoqatat të autorizuara të ofrojnë NJP;
- + Ministria e Punës dhe Politikës Sociale në strategjitë e veta për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi dhe barazi gjinore në mënyrë më aktive t'i inkuadrojë njësitë për vetëqeverisje lokale në mbrojtjen nga diskriminimi përmes planifikimit dhe buxhetimit të aktiviteteve specifike për forcimin e mekanizmave lokal për mundësi të barabarta dhe mbrojtjen nga diskriminimi dhe inkuadrimi i tyre në zbatimin e aktiviteteve në kuadër të strategjive dhe planeve për barazi gjinore dhe mundësi të barabarta lidhur me diskriminimin në nivel nacional.
- + Ministria e Punës dhe Politikës Sociale t'i përfshijë të gjitha bazat për mbrojtje nga diskriminimi në Strategjinë nacionale për barazi dhe jo diskriminim 2016-2020 me inkuadrimin eksplicit të orientimit seksual dhe identitetit gjinor si baza për parandalimin dhe mbrojtje nga diskriminimi;
- + Njësitë e vetëqeverisjes lokale ta rritin transparencën dhe llogaridhënien për punën, veçanërisht në kontekst të politikave të miratuara për mundësi të barabarta, jo diskriminim, përmes shpalljes publike në internet faqet e komunave) të Statuteve, Rregulloreve për punë të Këshillit të komunave dhe aktet tjera nënligjore, si dhe politikat për mundësi të barabarta dhe jo diskriminim, dhe raportet për punë të KMBGM dhe KMB;
- + Njësitë e vetëqeverisjes lokale ta rregullojnë dhe në mënyrë specifike ta vërtetojnë mandatin dhe kompetencat e vendit të punës në aktet për sistematizimin e vendeve të punës dhe Statutet e NJVL në pajtim me LMBGM dhe LPMD;

- + Njësitë e vetëqeverisjes lokale t'i zvogëlojnë ose tërësisht t'i eliminojnë përputhjet në obligimet e punës të KMB në pajtim me mandatin e paraparë me LMBGM dhe obligimet tjera që iu imponohen Koordinatorëve në suaza të NJVL, si kusht për përkushtim të tërësishëm të KMB ndaj detyrave dhe aktiviteteve të parapara për avancimin e mundësive të barabarta dhe mbrojtja nga diskriminimi në nivel lokal;
- + Njësitë e vetëqeverisjes lokale të planifikojnë në buxhetet vjetore mjete për iniciativa, masa dhe procedura në fushën e jo diskriminimit, veçanërisht në bazë të gjinisë, orientimit seksual dhe identitetin gjinor, në kuadër të planeve strategjike dhe aksionare për mundësi të barabarta dhe jo diskriminim në suaza të NJVL që i përpunon KMB dhe KMBGM;
- + Njësitë e vetëqeverisjes lokale t'i integrojnë ndër-seksionin strukturor deh politik të gjinisë me boshtet tjera të përjashtimit shoqëror dhe pabarazinë në suaza të planeve strategjike dhe aksionare të NJVL për barazi gjinore, mundësi të barabarta dhe jo diskriminim;
- + Njësitë e vetëqeverisjes lokale të përgatisin plan dhe të miratojnë mjete financiare për përmirësimin e kapaciteteve për kuptimin gjithëpërfshirës të konceptit për gjininë dhe barazinë gjinore për KMB, zëvendësit e AP dhe përfaqësuesit e zyrave rajonale të MD;
- + Njësitë e vetëqeverisjes lokale të përgatisin plan dhe të ndajnë mjete financiare për përmirësimin e vazhdueshëm të kapaciteteve të KMB, zëvendëseve të AP dhe të përfaqësuesve të zyrave rajonale të MD, në pjesën e njohurive relevante dhe bashkëkohore dhe fakte për homoseksualitetin dhe transgjininë, sensibilizimin e qëndrimeve dhe besimeve, si dhe për nevojat dhe gjendjet me të drejtat e njeriut të LGBT njerëzve;
- + Njësitë e vetëqeverisjes lokale të përgatisin plan dhe të ndajnë mjete financiare për përmirësimin e vazhdueshëm të kapaciteteve për rregulloren relevante anti-diskriminuese ligjore në R. Maqedonisë dhe mekanizmat për mbrojtje nga diskriminimi, veçanërisht në bazë të gjinisë, orientimit seksual dhe identitetit gjinor, e që do t'i adresonte veçanërisht përfaqësuesit e zyrave rajonale të MD;
- + Njësitë e vetëqeverisjes lokale ta forcojnë bashkëpunimin mes KMBGM dhe KMB në NJVL e vet dhe t'i kufizojnë kompetencat dhe mandatin e këtyre dy mekanizmave, e me qëllim që të shmanget përputhja e aktiviteteve dhe ngarkimi me obligime të njërit për llogari të mekanizmit tjetër;

- + Mekanizmat lokale për mbrojtje nga diskriminimi (KMBGM, KMB dhe AP) dhe qasja deri te drejtësia e qytetarëve në nivel lokal (përfaqësuesit e zyrave rajonale të MD) të vendosin dhe të zhvillojnë bashkëpunim për shkak të përcjelljes gjithëpërfshirëse të gjendjeve me mundësitë e barabarta dhe jo diskriminimin dhe planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve komplementare në drejtim të avancimit të gjendjes me të drejtat e njeriut në nivel lokal;
- + Mekanizmat lokal për mbrojtje nga diskriminimi (KMBGM, KMB dhe AP) dhe qasja deri te e drejta e qytetarëve në nivel lokal (përfaqësuesit e zyrave rajonale të MD) t'i inkuadrojnë dhe t'i mbështetin shoqatat të cilat punojnë në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtës së LGBT njerëzve;
- + Shoqatat lokale për mbrojtjen e të drejtave të LGBT njerëzve ta rritin komunikimin me mekanizmat lokal për mbrojtje nga diskriminimi për shkak të inicimit dhe përmirësimit të bashkëpunimit. Inicimi dhe forcimi i bashkëpunimit duhet të përfshijë projekte, trajnime të përbashkëta, shkëmbim të vazhdueshëm të informatave për gjendjet me diskriminimin në nivel lokal, inicimi i aktiviteteve të përbashkëta për promovimin e parimeve të jo diskriminimit në nivel lokal, dhe edukimi i qytetarëve për diskriminimin në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor;
- + Mekanizmat lokal për mbrojtje nga diskriminimi KMBGM, KMB dhe AP) dhe qasja deri te të drejtat e qytetarëve në nivel lokal përfaqësuesit e zyrave lokale të MD) në bashkëpunim me shoqatat të zhvillojnë dhe të miratojnë Protokoll për bashkëpunim dhe koordinim, me obligime qartë të caktuara, mes mekanizmave të ndryshëm për mundësi të barabarta dhe mbrojtje nga diskriminimi në nivel lokal dhe organizatat qytetare në nivel lokal dhe nacional, të cilët punojnë në fushën e barazisë gjinore dhe jo diskriminim në bazë të gjinisë, orientimit seksual dhe identitetit gjinor;
- + Avokati i popullit të zhvillojë metodologji moderne për evidentimin, përpunimin dhe prezantimin e rezultateve nga puna e zyrave rajonale të Avokatit të popullit në fushën e diskriminimit, me qëllim të vëzhgimit të trendit të shkeljes të drejtave dhe diskriminimit. Këto të dhëna do të ndihmojnë në krijimin e politikave lokale për mbrojtje nga diskriminimi i KMB, KMBGM, si dhe të shoqatave të cilat punojnë në komunën konkrete, me qëllim të eliminimit të pabarazisë gjinore dhe mbrojtjen nga diskriminimi i të gjithë qytetarëve nën kushte të njëjta.
- + Ministria e Drejtësisë t'i përmirësojë kapacitetet kadrovike, resurset themelore teknike dhe kushtet e zyrave rajonale të MD.

- + Ministria e Drejtësisë të sigurojë shkallë më të lartë të decentralizimit të kompetencave të zyrave rajonale të MD lidhur me mandatin e tyre sipas LNJP përmes mënjanimit të barrierave për inkuadrimin e tyre në aktivitete promovuese dhe vendimmarrje të pavarur për bashkëpunim me SHQ në nivel lokal.
- + Ministria e Drejtësisë të zhvillojë metodologji dhe sistem për evidencë në suaza të zyrave rajonale të MD lidhur me ndihmën juridike të kërkuar/siguruar, për atë se sa dhe cilët qytetarë, dhe për cilat probleme juridike është kërkuar ndihmë juridike e siguruar, dhe evidentimi eksplicit i rasteve të diskriminimit;
- + Mekanizmat lokal për mbrojtje nga diskriminimi që ta rritin prezencën e tyre në media, me qëllim të promovimit të punës së tyre në fushën e mundësive të barabarta dhe mbrojtjen nga diskriminimi dhe sensibilizimin e opinionit për çyshtje për mbrojtje nga diskriminimi në bazë të gjinisë, identitetit gjinor dhe orientimit seksual në nivel lokal.



Х. Е. Р. А.
Обединение за здравствена едукативна и информационна

A Member Association of



Kingdom of the Netherlands

